



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË FRËNGE

KODI: 3.2.12.B

**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË FRËNGE
PËR KLASËN E 12-TË**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Redaktore letrare: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies/mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor B2+ sipas Kuadrit të Përbashkët European për Gjuhët.

Ky program synon aftësimin e nxënësve si përdorues aktivë, përvetësimin dhe pasurimin e mëtejshëm të njohurive, shkathtësive e shprehive për përdorimin e gjuhës frënge si mjet komunikimi në situata të larmishme jetësore, me të cilat ata mund të përballen, duke argumentuar qartë qëllimin e komunikimit dhe përdorimin e gjuhës në përshtatje me statusin e bashkëfolësve.

Mbështetur në filozofinë dhe në udhëzimet e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe në Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, programi i klasës së 12-të përfshin të gjitha njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfuara, duke nxjerrë në pah baraspeshën e njohjes së gjuhës frënge me nevojën e nxënësit për të thelluar këto dije dhe, njëkohësisht, për të rritur aftësitë e tij shprehëse në këtë gjuhë, drejt formimit të tij si përdorues i pavarur.

Programi ndërtohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmohës dhe kontribuon në zhvillimin e pavarur, intelektual dhe social-kulturor të nxënësit, në mënyrë që ai/ajo të jetë i/e aftë të përballojë të nxënët gjatë gjithë jetës. Ai synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe pavarësinë e nxënësit, në klasë e jashtë saj, duke nxjerrë forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj në grup.

Njohuritë e përfuara në këtë program, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re, mundësojnë rritjen dhe forcimin e njohurive të nxënësit jo vetëm në gjuhën frënge, por edhe në lëndët e tjera, si p.sh., në histori, arte, guidë turistike, gjuhë moderne, gjeografi, letërsi etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike. Kjo ndërthurje ndërlëndore merr një dimension të ri në përpjekjen për të përfuor dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, që përgatisin nxënës/in,-en të përballen me studime të mëtejshme, si dhe me punësimin brenda ose jashtë vendit.

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të është konceptuar dhe përpiluar në mënyrë të tillë që, me anë të dijeve që nxënës/i,-ja merr gjatë procesit mësimor, të zhvillojë personalitetin e tij/saj, duke rritur besimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Synimi i gjuhës së huaj në këtë fazë të formimit është të perfeksionojë aftësitë e fituara në nivelet e mëparshme, në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë të konsolidojë nivelin B2+, duke u aftësuar gjithnjë e më shumë si një përdorues/e i/e pavarur i gjuhës. Në këtë nivel synohet që nxënës/i,-ja të bëhet sa më i pavarur. Nxënës/i,-ja, në këtë nivel, duhet të jetë i aftë:

- T'u përgjigjet situatave të paparashikuara të jetës së përditshme, si dhe situatave të tjera të veçanta duke vendosur lidhjet e tij/saj me situatën dhe bashkëfolësin;
- të përpunojë informacionin e marrë, duke shprehur qëndrimin e tij/saj ndaj problemit në fjalë;
- të ushtrohet në veprimtari individuale dhe të punës në grup për arritjen e objektivave të të nxënët;
- të përsosë aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata të veçanta të jetës së përditshme;
- të forcojë ndërveprimin në kontekstin mësimor, si dhe t'i përgjigjet këtij ndërveprimi duke përdorur të katër kompetencat gjuhësore;

- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të ka si objektiv të përgjithshëm të pasqyrojë dhe të ndërthurë njohuritë e gjuhës frënge me njohuritë e lëndëve të tjera. Objektivat synojnë që nxënës/i,-ja:

- Të zhvillojë aftësitë leksiko-gramatikore dhe kulturore, për të ndërtuar një personalitet gjithnjë e në rritje në përgjigje të kërkesave shtruar nga Kuadri i Përbashkët European i Referencave për Gjuhët, si dhe nga dokumentet bazë, nënshkruar nga MASH-i.
- Të përsosë nivelin gjuhësor, duke realizuar ndërveprim dhe shkëmbim komunikativ në situata bashkëvepruese.
- Të mbajë qëndrim ndaj materialeve burimore në shërbim të të mësuarit duke krahasuar, argumentuar e mbajtur qëndrim rreth tematikës e problematikave që trajtohen.
- Të ndërthurë njohuritë e përfuara në fushat e tjera të të nxënës, duke perfeksionuar të katër aftësitë e të nxënës të gjuhës së huaj.
- Të ndërthurë njohuritë e përgjithshme me ato specifike në përputhje me aftësitë dhe shprehitë individuale të tij/saj.
- Të thellohet në aftësinë për të vënë në dukje, për të krahasuar dhe për të bërë dallime ndërmjet kulturave të ndryshme, për t'iu përshtatur sa më mirë komunikimit ndërkulturor european.
- Të zhvillojë më tej aftësinë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike duke konsoliduar shprehitë dhe proceset e të menduarit kritik dhe krijues.

3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi: Objektivat sipas standardit në komunikim aftësojnë nxënës/in,-en me aktet e komunikimit dhe në rëndësinë e tyre në përshtatje me kërkesat dhe standardet e Kuadrit të Përbashkët European për Gjuhët. Kjo e bën nxënës/in,-en përdorues/e të pavarur të gjuhës frënge. Nxënësi, në këtë nivel, specifikon regjistrin e gjuhës, fushën e përdorimit, elementet etiko-emocionale që lidhen me gjestet e traditën, specifikon pasthrrmat si elemente të rëndësishme në sigurimin e funksioneve ndërvepruese të komunikimit. Në këtë nivel, nxënës/i,-ja, si përdorues i pavarur, shpreh opinionin, mendimet duke i sintetizuar dhe duke i argumentuar ato.

Standardi	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë parashikime duke ngritur edhe hipoteza rreth një situate problemore; • të interpretojë një informacion të dhënë nga fusha të

	<p>ndryshme të interesit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë thelbin dhe detajet e një bisede; • të ndryshojë formulimin e tij për të shmangur përsëritje të shpeshta, apo mangësi leksikore, që mund të shkaktojnë ende hezitime dhe përdorime të perifrazave; • të bëjë të qartë lidhjet shkak-pasojë në një situatë të dhënë; • të shprehë pikëpamjet e tij/saj, duke i mbështetur në argumente dhe fakte të dhëna nga dokumentet burimore apo jeta e përditshme; • të krahasojë zgjidhje të ndryshme duke argumentuar zgjedhjen e tij/saj; • të justifikojë zgjidhjen e parashtruar të një problemi; • të bëjë dallimin mes fakteve dhe interpretimit të tyre; • të klasifikojë pikat e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të një diskutimi, duke argumentuar pikat pro dhe kundër; • të debatojë për të mbrojtur argumentet dhe qëndrimin e tij/saj ndaj një teze apo ideje të caktuar; • të hartojë një tekst argumentues, duke respektuar qëllimin, si dhe rregullat strukturore dhe ato etike në përshtatje me qëllimin e këtij argumentimi.
<p>Veprimtaritë e komunikimit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të miratojë idetë dhe përvojat e të tjerëve; • të kundërshtojë në debat, me argumente të bazuara, një ide apo opinion, duke mbrojtur pikëpamjen e tij/saj rreth temës së debatuar; • të formulojë një ankesë, duke negociuar për zgjidhjen e saj; • të propozojë zgjidhje për situata të caktuara; • të mbështesë me mjete sociale-gjuhësore ndjenjat dhe qëndrimet e tij/saj, si: keqardhjen, çudinë, dëshirën, urimin etj; • të nxisë marrjen pjesë në shtrimin e një diskutimi, duke krijuar mundësi të njëjta për të gjithë; • të verifikojë detajet mbështetëse të një argumenti për përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursione, diskutime rreth aktualitetit, interesat në fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore etj.

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor, duke vënë theksin në përsosjen e aftësive ligjërimore në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor.

Standardi	Objektivat
Kultura	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të përdorë gjuhën frënge në situata të ndryshme gjuhësore dhe kulturore, duke ua përshtatur regjistrin e komunikimit gjuhësor audiencës dhe qëllimit të komunikimit (normal, informal, miqësor, konfidencial, zyrtar etj.);• të përdorë strategjitë e duhura të të nxënës me qëllim zgjerimin e mëtejshëm të aftësive sociale-linguistike dhe sociale e kulturore;• të thellojë njohuritë e tij/saj për kulturën frënge, si dhe për personalitete të ndryshme të saj, për ngjarje dhe personalitete përfaqësuese të epokave, të ngjarjeve të ndryshme me karakter formues në botën frankofone;• të përdorë saktë shenjat sociale-gjuhësore, si p.sh., gjestet, intonacionin në ligjërim etj., që përcaktojnë qëndrimin ndaj bashkëfolësve në bashkëbisedim;• të motivojë shijet dhe zgjedhjet personale dhe të grupit që përfaqëson mbi artin e kulturën, shkollën dhe jetën e përditshme, duke motivuar zgjedhjet e tij/saj (grupit që përfaqëson);• të komentojë vlerat e një emisioni televiziv a radiofonik, një filmi, një drame, një koncerti apo një veprë letrare, duke i analizuar dhe krahasuar elementet e veçanta në sjelljen e personazheve dhe duke argumentuar edhe mendimin e tij/saj.

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor synojnë të përsosin përdorimin nga ana e nxënës/it,-es, si përdorues i pavarur, të elementeve gjuhësore në situata të ndryshme, duke përdorur gjithë aftësitë gjuhësore, strukturat gramatikore, rendin e fjalëve, raportet mes kategorive të ndryshme gramatikore dhe ndërvarësinë e tyre reciproke në ligjërim. Nxënës/i,-ja, në këtë nivel, shprehet qartë me struktura të ndërthuara mirë, ndërvepron me bashkëfolës, duke përshtatur mirë elementet morfologjike dhe ato sintaksore në fjali.

Në këtë nivel nxënës/i,-ja aftësohet të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B2+, duke realizuar kështu një formim gjuhësor që lejon komunikim të lirshëm, përdorim aktiv dhe pragmatik të gjuhës. Në këtë nivel, bëhet thellimi dhe perfeksionimi i njohurive gramatikore të përfutuara duke lejuar një komunikim më të nuancuar. Nxënës/it,-et, në këtë nivel, zotërojnë mirë sistemin gramatikor e morfologjiko-sintaksor që u lejon të shprehen lirshëm, pa ose me pak gabime, me lidhje logjike dhe me një rrjedhshmëri të mirë, duke mbështetur dhe argumentuar idetë e tyre.

Standardi	Objektiva
<p>Elemente gramatikore</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë një kontroll mjaft të mirë gramatikor për të mos bërë gabime që sjellin keqkuptime; • të ketë një kontroll të mirë gramatikor, duke përdorur saktë format morfologjike e sintaksore me gabime të vogla sintaksore të rastësishme e josistematike, të cilat mund të korrigjohen retrospektivisht; • të ketë një shqiptim dhe një intonacion të mirë dhe natyral; • të prodhojë një shkrim të bashkërenduar, të lirë dhe logjik, duke zbatuar rregullat e përdorimit dhe të organizimit; • të përdorë drejtshkrimin dhe shenjat e pikësimit relativisht të sakta, por që mund të pësojnë ndikimin e gjuhës amtare; • të bëjë një përshkrim ose një tregim të lirë në zhvillim dhe duke argumentuar pikat e rëndësishme, me ndihmën e detajeve dhe shembujve domethënës; • të përdorë me efikasitet një larmi të madhe fjalësh lidhëse për të shënuar, theksuar marrëdhëniet mes ideve; • të përdorë saktë në mënyrë krijuese foljen si kategori, duke ua përshtatur drejt vlerat modale dhe kohore situatave të ligjërimit me shkrim dhe me gojë; • të përdorë saktë, në kontekstin e duhur, ligjëratën e drejtë dhe atë të zhdrejtë, duke realizuar përshtatjet e duhura morfologjike e sintaksore; • të përdorë saktë të gjitha elementet morfologjike e sintaksore të shprehura me përemra dhe mbiemra në varësi të qëllimit, kontekstit të ligjërimit; • të ndërtojë drejt fjalinë e përbërë, duke përdorur drejt artikulorët dhe respektuar elementet e koherencës dhe të kohezionit.

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
<p>Të dëgjuarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ndjekë lehtësisht një bisedë të gjallë midis folësish vendës, duke identifikuar me saktësi argumentet që mbështesin dhe kundërshtojnë pikëpamjet; • të ndjekë, me pak sforcim, pjesën më të madhe të një bisede autentike bërë në praninë e tij; • të kuptojë në detaje një ligjërim në gjuhë standarde, edhe pse të zhvilluar në një ambient të zhurmshëm; • të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimi të ndërlikuar në brendi dhe në formë, mbi një temë konkrete ose abstrakte cilado qoftë ajo; • të përthithë përmbajtjen informative të një materiali të regjistruar, si dhe të kuptojë pikëpamjen dhe qëndrimin e folësve, nëpërmjet elementeve të intonacionit që përdoren; • të ndjekë një argumentim apo debat kompleks, mbi një temë të njohur dhe të strukturuar qartë; • të ndjekë një leksion, një bisedë të drejtpërdrejtë apo një regjistrim radio-televiziv mbi tema të njohura dhe të panjohura, që lidhen me veprimtarinë personale, shoqërore apo akademike; • të kuptojë emisione televizive, intervista, drama, filma dhe gjini të tjera të spektaklit, të shprehura në gjuhë standarde.
<p>Të lexuarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë në mënyrë të pavarur, duke ua përshtatur mënyrën dhe shpejtësinë e leximit teksteve të ndryshme dhe objektive, duke përdorur referenca të përshtatshme në mënyrë përzgjedhëse; • të zotërojë një fjalor leximi të gjerë dhe aktiv me pak vështirësi në disa shprehje të panjohura; • të lexojë një korrespondencë të përditshme të fushës së tij/saj dhe të kapë thelbin e kuptimit; • të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, të ndjenjave dhe të dëshirave në mënyrë të mjaftueshme për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një korrespondent mik; • të përshkojë shpejt një tekst të gjatë dhe kompleks; • të kapë me shpejtësi përmbajtjen dhe domethënien e

	<p>lajmeve, artikujve mbi tema që lidhen me interesat e tij/saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë shpejt përmbajtjen, duke përzgjedhur informacionin e përshtatshëm nga artikuj dhe reportazhe, si dhe të vendosë nëse i duhet një studim më i thellë; • të kuptojë artikuj të specializuar jashtë fushës së tij të interesit, duke lejuar që t'i referohet herë pas here fjalorit, për të verifikuar kuptimin.
<p>Të folurit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të komunikojë me njëfarë sigurie mbi tema të njohura, të zakonshme ose të ndryshme nga interesat e tij; • të shkëmbejë në mënyrë të pavarur informacione; • të përballojë jo vetëm situata të zakonshme, por edhe të paparashikuara, duke realizuar një ndërveprim, një komunikim me folës vendës (francezë), duke sjellë një informacion konkret; • të përballojë një debat, duke identifikuar qartë argumentet në mbështetje apo kundër pikëpamjes së tij/saj; • të shprehë mendimet e tij/saj me saktësi, duke parashtruar bindshëm argumentet e veta; • të shtrojë qartë një çështje, problem duke arsyetuar rreth shkakut dhe pasojës, si dhe duke vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet e qasjeve të ndryshme; • të raportojë informacione dhe argumente nga një numër burimesh si dhe të arrijë në përfundimet e duhura; • të bëjë përshkrime dhe prezantime të qarta dhe të detajuara, duke parashtruar ide të rëndësishme dhe duke i mbështetur me shembujt e duhur; • të negociojë për zgjidhjen e një problemi që ka ngjallur debat; • të japë qartë e rrjedhshëm njoftime për çështje të përgjithshme, pa shkaktuar keqkuptime dhe vështirësi të dëgjuesi.
<p>Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë tekste të qarta dhe të hollësishme mbi një gamë të gjerë temash në lidhje me fushën e tij/saj të interesit; • të bëjë sintezën dhe vlerësimin e informacioneve dhe të argumenteve të marra nga burime të ndryshme; • të shkruajë përshkrime të përpunuara për ngjarje dhe përvoja reale ose imagjinare, duke treguar lidhjet midis ideve në një tekst me rrjedhë logjike, si dhe duke respektuar rregullat e gjinisë në fjalë;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë përshkrime të qarta dhe të hollësishme mbi një larmi temash në lidhje me fushën e tij/saj të interesit; • të shkruajë një kritikë të një filmi, të një libri apo të një pjese teatrale; • të shkruajë një esé ose një raport që zhvillon një argumentim në mënyrë metodike, duke theksuar në mënyrë të përshtatshme pikat e rëndësishme dhe hollësitë e spikatura që e mbështesin atë; • të vlerësojë idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi; • të shkruajë një esé ose një raport që zhvillon një argumentim, duke justifikuar pro ose kundër një pikëpamje të veçantë dhe duke shpjeguar përparësitë ose problemet e opsioneve të ndryshme.
--	--

5. KËRKESA TË GJUHËS FRËNGE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të, bazuar në kurrikulën bërthamë të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja, siguron integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për përdorimin dhe për përsosjen e njohurive gjuhësore, në përgjithësi, dhe të katër aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit), në veçanti.

Konceptet gramatikore, nocionet leksikore trajtohen në kontekste të lidhura pazgjidhshmërisht me njohuri, tematika të parashtruara në programet e tjera lëndore, si dhe në dokumente të tjera burimore të përdorura në procesin e edukimit.

Shpjegimit të marrëdhënieve sintaksore që bëhen evidente në këtë nivel për të shprehur dhe nuancuar idetë, pikëpamjet dhe opinionet i shërben studimi i gjuhëve dhe i strukturave të tyre, duke i krahasuar respektivisht me struktura të gjuhës amtare.

Studimi i dokumenteve burimore të çdo natyre, gjykimi për materialin dhe idetë që këto dokumente paraqesin, për kontekstin historik, për problematikën dhe për autorin na çojnë drejt një ndërveprimi mes gjuhës së huaj dhe historisë, sociologjisë, letërsisë.

- Njohuritë që merren në gjuhën frënge dhe në shkencat e natyrës, si në biologji, kimi, fizikë, reflektohen në trajtimin e temave rreth mjedisit, artit kulinar, kinemasë si shkencë dhe si art etj.
- Njohuritë që nxënës/i,-ja merr nëpërmjet artit dhe kulturës frënge, gjejnë shprehjen e tyre në aktivitetin dhe kontributin e personaliteteve në fushën e sportit, muzikës, modës dhe pikturës.
- Njohuritë e shkencave sociale, si të sociologjisë, të filozofisë e ndihmojnë nxënësin për të formuluar drejt idetë, si dhe për të mbajtur qëndrim ndaj dokumenteve burimore që studiohen në klasë. Kështu, lufta kundër diskriminimit, kundër racizmit, përbëjnë një fushë të rëndësishme interesi në trajtimet tematike të këtij niveli.
- Tema, si marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, marrëdhëniet në komunitet, qëndrime etike të caktuara, si dhe veprimtaritë e organizatave humanitare vihen në

zbatim përmes projekteve ndërkurrikulare që ndërthuren gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies së gjuhës së huaj.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përdoruesit e tij (mësues, nxënës etj.).

Mësuesit duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës frënge për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse për të përcaktuar objektiva realë sipas kërkesave të kurrikulës dhe të Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

A. Objektivat

Bazuar në orientimet mbi objektivat e arritjeve në procesin mësimor, është e rëndësishme që mësuesi të përshtatë veprimtarinë mësimore në varësi të niveleve të ndryshme të nxënësve në klasë.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë atë që përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë mbi një dokument autentik.

Në një nivel të ulët, mësues/i,-ja i kërkon nxënës/it,-es thjesht të evidentojë personazhet dhe idetë e paraqitura në dokumentin burimor, p.sh., të evidentojë në dokumentin e paraqitur atë çfarë sheh, si dhe mesazhin që ai përcjell).

Në një nivel më të lartë, mësuesi u propozon nxënësve në grup të tregojnë në mënyrë të përmbledhur se çfarë është shprehur në dokumentin burimor, duke e vendosur atë në një kuadër kohor të caktuar, si dhe në problematikën që përfaqëson.

Për një nivel më të avancuar, mësuesi u propozon nxënësve më të mirë të nxjerrin konkluzione dhe të formulojnë qëndrimet, idetë e tyre rreth dokumentit në fjalë, duke vënë në dukje problematikën e trajtuar, si dhe zgjidhjet e mundshme të problemit të trajtuar.

B. Orët mësimore

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia/mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10 % (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Kjo do të thotë që mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur ata demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës frënge, afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30% e tyre janë për rimarrjen dhe përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha frënge për klasën 12-të zhvillohet me 4 orë mësimore në javë:

34 javë x 4 orë = 136 orë vjetore

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në unitete e njësi mësimore) linjat dhe nënlinjat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një uniteti ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes dhe shpërndarjes së orëve për sa vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zënë 104 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 90 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70%, që përbëjnë 63 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30%, që përbëjnë 27 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 14 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 32 orë. Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 23 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme.);
- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit kritik e krijues;
- kultivimit të aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimin etik-social dhe atij gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të nxiten nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës frënge në nivelin B2+. Realizimi i orëve të përgjithshme (136 orë në vit) është sa i detyrueshëm, aq edhe elastik. Është i detyrueshëm, sepse duhen zhvilluar të gjitha orët e planifikuara deri në fund të vitit shkollor. Është elastik, sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të gjuhës frënge. P.sh., 10% të orëve mësuesit janë të lirë t'i përdorin në varësi të arritjes së objektivave.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies

Për të drejtuar me kujdes procesin e mësimdhënies dhe për të arritur rezultate progresivisht në ngjitje, është e domosdoshme që mësuesi të drejtojë me kujdes të nxënët, progresin në mësimin e gjuhës së huaj, të ngjallë me anë të strategjive dhe të metodologjisë ndërgjegjësimit dhe dinamikë në procesin e të nxënët.

Gërshetimi i objektivave specifike, pa neglizhuar asnjërën nga aftësitë gjuhësore, përbën një detyrim për mësuesin në zbatim të programit dhe të gjithë dokumentacionit të nënshkruar nga MASH-i për arsimin parauniversitar. Për rrjedhojë, gërshetimi i metodave dhe i teknikave përbën një domosdoshmëri në realizimin e orës së mësimit dhe në arritjen e objektivave mësimorë.

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë lidhur me katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- të arsyetojë mbi bazën e asaj që dëgjon;
- të përdorë njohuritë e tij/saj të mëparshme;
- të bëj lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- të përpiqet që, gjatë dëgjimit, të kuptojë referencat kulturore të panjohura për të, duke përdorur kontekstin për të hamendësuar se kujt i referohen ato.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit përsëritje, në rast moskuptimi;

- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- të përdorë shprehje tipike të gjuhës frënge, me qëllim që të fitojë kohë për gjetjen e fjalës së duhur;
- të përsërisë një pjesë të asaj çfarë thotë bashkëfolësi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimi, dy rreshtat e parë të mësimi;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura në kontekst;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të hamendësojë përgjigjet e mundshme;
- të gjejë në tekst përgjigjet e pyetjeve, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor dhe detajet përkatëse;
- të mbajë shënime gjatë një bisede ose diskutimi, për të përmbledhur mendimin e tij/saj.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të redaktojë shkrimin e tij/saj ose të këmbëjë punën e tij/saj me atë të shokut/shoqes.

C. Parime për zbatimin e programit

Ky program është dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përdoruesit e tij dhe bazohet në parimet e mëposhtme:

Demokratizimi dhe modernizimi i orës së mësimi dhe i marrëdhënieve në klasë

Për të vendosur nxënës/in,-en në qendër të mësimdhënies/mësimnxënies, janë të domosdoshme demokratizimi i orës së mësimi, i shprehur me lirinë e fjalës e të mendimit që bën të mundur krijimin e një mjedisi të ngrohtë e interaktiv në shërbim të mësimi; si dhe përdorimi i teknologjisë në orën e mësimi duke respektuar kërkesat e programit dhe udhëzimet e MASH-it.

Krijimi i mjedisi të të nxënës

Krijimi i një mjedisi gjuhësor motivues, konkurrues, dhe miqësor rrit rezultatet e mësimdhënies/mësimnxënies. Organizimi i diskutimit të lirë, respekti ndaj fjalës përbën një ndër faktorët nxitës të ligjërimin dhe të komunikimit ndërveprues në klasën e gjuhës së huaj.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja dhe nxënësit bashkëpunojnë për organizimin dhe lehtësimin e mësimdhënies/mësimnxënies. Mësues/i,-ja gjen mënyra frytdhënëse për veprimtaritë komunikuese, siguron dhe sugjeron materiale burimore për nxënësit etj. Mësues/i,-ja i qartëson nxënësit dhe merr mirëkuptimin e tyre për atë çfarë ndodh në klasë. Kjo nënkupton sqarimin e rregullave të radhës së punës dhe të përgjegjësive të nxënësve në procesin e kryerjes së veprimtarive. Mësues/i,-ja sugjeron dhe siguron përdorimin e mjeteve audiovizuale (elektronike), si dhe ndihmon nxënësin/in,-en në përdorimin e formave të ndryshme të teknologjisë informative brenda dhe jashtë klase. Ai/ajo u tregon nxënësve epërsitë në përputhje me moshën dhe kërkesat shkollore.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësues/i,-ja krijon kushtet për realizimin e mësimin bashkëkohor, duke realizuar veprimtari në grupe apo çifte, duke siguruar jo vetëm ndërveprimin gjuhësor, por dhe bashkëpunimin mes nxënësve për realizimin e veprimtarive në klasë. Bashkëpunimi i bën nxënësit më të lidhur me njëri-tjetrin, por dhe më të pavarur në shprehjen e mendimit dhe në respektimin e ideve të të tjerëve.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor B2+, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën frënge në situata të larmishme komunikimi për veprimtari që lidhen me kontekstin e veprimtaritë e tij.

Të mësuarit e gramatikës

Në kuadër të respektimit të Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, njohuritë gjuhësore dhe veçanërisht ato gramatikore janë në shërbim të funksionit komunikativ të gjuhës, cilësia e të cilit varet nga saktësia gramatikore dhe nga rrjedhshmëria gjuhësore gjatë ligjërimit me shkrim dhe me gojë.

Korrigjimi i gabimeve

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të pasqyron më së miri mënyrën e korrigjimit të gabimeve. Niveli B2+ parashikon që nxënësit të aftësohen që të vetëkorrigjohen ose të korrigjojnë njëri-tjetrin, dhe të mësojnë prej gabimeve që ata bëjnë. Shpesh mësues/i,-ja shënon gabimet e përsëritura dhe, kur është e nevojshme, i korrigjon ato, duke i qartësuar dhe duke përdorur format e sakta gjuhësore në strukturë për të formuar te nxënësi shprehje për strukturën e dhënë.

Puna e diferencuar me nxënësit

Në kushtet e mësimdhënies së gjuhës së huaj në shkolla kombëtare të profilit gjuhësor, mësuesi, i gjendur para nxënësish me prejardhje krahinore, domethënë, me karakteristika fonologjike të ndryshme, me prirje dhe dëshira të larmishme, me temperamente dhe interesa të shumëllojshme, duhet të konceptojë në punën e tij edhe një dimension të punës së diferencuar, me grupe dhe me nxënës të veçantë.

Një nga metodat e punës për të siguruar ndërveprimin në mësimin e gjuhës së huaj është puna në grupe, në të cilën mësuesi duhet të konceptojë veprimtari të larmishme, që tërheqin vëmendjen e

interesat e grupeve dhe të nxënësve të veçantë, duke ua përshtatur veçorive dhe interesave të tyre. Duke synuar objektiva të arritjeve gjithnjë në rritje, mësuesi duhet të konceptojë detyra të larmishme me shkallë vështirësie në rritje, duke vlerësuar nxënësin në progres.

Për të realizuar një ndër objektivat e kurrikulës sonë kombëtare, integrimin ndërlëndor në procesin mësimor, mësuesi motivon, gjithashtu, nxënësit e përparuar nëpërmjet veprimtarive shtesë, si dhe përzgjedhjes së materialeve autentike, nxitjes së veprimtarive kulturore me bazë gjuhën e huaj, si: recitime, vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj, ekspozita etj. Duke konsideruar formimin shumëgjuhësor të nxënësve si pjesë përbërëse e edukimit në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, mësuesi nxit studimin, krahasimin mes strukturave gjuhësore të veçanta. Nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Mësuesi bashkërendon punën për veprimtari paralele me mësuesit e gjuhës amtare dhe të gjuhëve të tjera simotra, duke motivuar veprimtari dhe detyra të pavarura të nxënës/it,-es në mënyrë individuale apo grup për realizimin e projekteve të ndryshme kurrikulare.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i mbështetur në objektivat e programit lëndor nuk ka qëllim të vetëm vlerësimin e njohurive të nxënësit, por mbi të gjitha, përparimin e tij për arritjen e objektivave të programit mësimor.

Çdo veprimtari e akt komunikimi duhet të vlerësohet në kuadrin e arritjeve të të nxënësit në mënyrë që hap pas hapi të realizohen objektivat e përgjithshëm dhe ata specifike për mësimin e gjuhës së huaj në përputhje me kornizën kurrikulare, me Kuadrin e Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe me dokumentacionin e MASH-it, që jo vetëm përshkruajnë gjithë procesin mësimor, por shërbejnë edhe për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Vlerësimi duhet t'i përmbahet vetëm standardeve që përkohjnë me nivelin B2+, të parashtruara në program.

Vlerësimi nuk përfshin vetëm realizimin e standardeve rreth njohurive dhe aftësive, por edhe të qëndrimet e nxënësve, si p.sh., qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi, si një nga aspektet përbërës të këtij programi, siguron:

- Një matje të vazhdueshme të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën frënge;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore dhe të metodave të mësimdhënies, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një plan pune për përmirësimin e njohurive të nxënës/it,-es.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi kalon përmes disa etapave, të cilat përfshijnë kontrollin, matjen dhe vlerësimin.

Kontrolli lidhet me rrugën e përfuturit të informacionit mbi atë që ka arritur dhe atë që nuk ka arritur nxënësi gjatë të mësuarit. Kontrolli realizohet në forma të ndryshme dhe në çdo moment të të mësuarit.

Matja shpreh rezultatin e kontrollit krahasuar me kushte, me kritere, me standarde të caktuara paraprakisht dhe paraqitet në pikë, në përqindje etj. Duhet thënë se jo çdo kontroll përfundon me matje.

Vlerësimi lidhet me vendosjen e vlerës me anë të notës, shprehjes me fjalë (*shumë mirë, mirë, mjaftueshëm* etj.) në përputhje me gjykimin sasior, cilësor që rezulton nga kryerja e matjes.

Përdormi i formave të kontrollit të Tipit DELF të jetë në qendër të kontrollit, duke kontrolluar njëherazi të gjitha aftësitë e të nxënësit në gjuhë të huaj, në varësi të nivelit të dijeve për nxënës e grup nxënësish të veçantë. Për orientim të përdoren testet dhe format e testeve të përdorura nga autorët e teksteve në brendësi të vetë tekstit bazë.

Korrigjimi i gabimeve t'i shërbejë, së pari, procesit të të nxënësit, duke synuar shpjegimin, aplikimin e drejtë të çdo dijeje leksiko-gramatikore dhe, më pas, vlerësimin të njohurive, dijeve të përfuturta.

Për të formuar njohuri të qëndrueshme të nxënësit, krahas larmisë së metodave dhe të strategjive në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, është i rëndësishëm përdorimi i formave të larmishme në procesin e vlerësimin.

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike, ka lidhje me atë që është mësuar gjatë një jave, një muaji ose një semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe me programin. Vlerësimi i dijes është i bazuar në orën e mësimit. Kështu, ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive ose i performancës) është vlerësimi i asaj që nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësim formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/mësimnxënies.

Vlerësim i planifikuar, mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli, bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

Vlerësim motivues ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës frënge. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësuesi realizon këtë lloj vlerësimi, duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si p.sh.: *mirë, shumë mirë* etj., dhe duke përdorur materiale që nxisin vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh., përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënësit si pjesë e Portofolit Europian të Gjuhëve, ku nxënësi vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj., që provojnë ecurinë e tij në gjuhë.

Vlerësim përfundimtar është vlerësim me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe të nënlinjave për këtë grupmoshë.

Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm, gjë që tregohet më së miri në realizimin e standardeve. Mësues/i,-ja vlerëson vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi e vetëvlerësimi.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës frënge, ku çdo nxënës/e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit të njohurive nga mësues/i,-ja, nga prindërit dhe nga institucionet e arsimit. Vetëvlerësimi ka efekt kur:

- U referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Përbashkët European iReferencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën dhe nivelin e tyre,
- lidhet me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vetëvlerësimi i nxënies bëhet i matshëm nëpërmjet përcaktimit të synimeve të qarta në program. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

Portofoli European i Gjuhëve është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGj-i e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ-i e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit. Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare. Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe tregon arritjet e tij/saj.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.